



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 1240 prot.

Tiranë, më 05/08/2025

Vendim nr. 47 datë 05.08.2025

Për ringritjen e njësisë studimore të përkohshme

“Pasuritë Ujore”

Bazuar në nenin 4 dhe nenin 19 pikat të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; nenit 44 të Statutit të Akademisë së Shkencave, i ndryshuar; pas shqyrtimit të kërkesës së drejtuesit të njësisë “Pasuritë Ujore” për zgjatjen e mandatit 2-vjeçar, njohjen e raportit të veprimtarisë të kësaj njësie për periudhën maj 2023 – maj 2025, dhe propozimet për veprimtarinë kërkimore shkencore për vitet 2025-2027 (bashkëlidhur), konsultimit me komisionin e përhershëm të fizikë-kimisë dhe miratimin nga anëtarët e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (bashkëlidhur); Kryesia e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e datës _____.____.2025,

Vendosi:

1. Të ringrejë njësinë kërkimore të përkohshme “Pasuritë Ujore”, e cila ka vepruar deri me datë 02.05.2025 sipas vendimit të Kryesisë nr. 19, datë 02.05.2023, edhe për dy vjet të tjera.
2. Njësia “Pasuritë Ujore” të vazhdojë të veprojë në përputhje me dokumentat bazë të themelimit: akti i krijimit dhe i caktimit të bordit drejtues miratuar me VKA nr. 19 datë 2.5.2023. Detyrën e koordinatorëve të vijnë ta kryejnë dr. Rozarta Nezaj (pedagoge në Universitetin Bujqësor të Tiranës) dhe msc. Nensi Isak (pedagoge në Universitetin e Tiranës), sipas VKA nr. 7, datë 5.2.2025.
3. Propozimet e paraqitura nga akad. Besnik Baraj, programuar edhe në programin vjetor të ASH-së, miratuar me vendim të Asamblesë nr. 12 datë 28.02.2025, të shërbejnë si plan pune për vitin 2025.
4. Brenda muajit shtator 2025 bordi drejtues të paraqesë programin përfundimtar për dy vitet në vazhdim (shtator 2025 – shtator 2027).

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetari i SSHNT, drejtuesi i njësisë, kancelari, sektori i buxhetit dhe financës dhe specialistja e burimeve njerëzore dhe juriste.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder Gjinushi

KRYETAR

Në mungesë dhe me porosi

Akademik Vasil S. Tole

ZËVENDËSKRYETAR

